

Vlerësimi i Strategjisë së Punësimit: nevoja për një strategji konkrete

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia e Punësimit 2010-2012 ishte një dokument i Qeverisë së Kosovës i cili synonte krijimin e vendeve të punës përmes investimit në tri fusha kryesore: në përmirësimin e klimës së investimeve, në arsimin formal dhe trajnimin profesional të kapitalit njerëzor dhe në modernizimin e institucioneve të tregut të punës. Ndonëse që të tria këto në strategji përmenden si sfida afatgjate, periudha kohore e strategjisë ishte vetëm tre vjeçare. Katër vite pas miratimit të kësaj strategjie, Instituti GAP ka analizuar efikasitetin e saj në përmirësimin e ambientit të punësimit në vend, duke arritur në përfundim se: strategjia ka qenë shumë e përgjithësuar, asaj i kanë munguar objektiva të qarta dhe të matshme, ajo nuk ka përmendur mekanizma për krijimin e punëve afatgjate, si dhe strategjia nuk përmbante pako stimuluese financiare për zgjerimin e firmave të vogla dhe të mesme dhe kalimin e bizneseve nga ekonomia joformale në atë formale. Andaj, Instituti GAP sugjeron që Qeveria e Kosovës të bëjë një vlerësim të detajuar të efektit të kësaj strategjie, të përgatisë një strategji më afatgjate dhe me objektiva të qarta rreth numrit të vendeve të reja të punës që synohen të krijohen ndër vite, si dhe strategjia e re të përmbajë stimulues financiar për hapjen e bizneseve të reja dhe zgjerimin e atyre ekzistuese.

II. HYRJE

Punësimi dhe papunësia janë dy veçoritë kryesore të tregut të punës. Edhe pse ato janë të ndërlidhura mes veti, kjo nuk do të thotë se ulja e punësimit automatikisht çon në ngritjen e papunësisë në shkallë të njëjtë, apo edhe e kundërta se rritja e shkallës së punësimit çon në uljen e njëjtë të shkallës së papunësisë. Siç shpjegon Lyuben Tomew, kjo ndodh për shkak se shkalla e papunësisë dhe e punësimit llogariten në mënyra të ndryshme. Shkalla e punësimit nënkupton shkallën e të punësuarve në krahasim me numrin e përgjithshëm të popullatës që kanë të drejtë të punojnë, kurse shkalla e papunësisë nënkupton shkallën e të papunëve në mesin e fuqisë punëtore (që është ekonomikisht aktive)¹. Ai shton se punësimi mund të ndodh përmes vendosjes së marrëdhënies së punës, përmes vetë-punësimit apo përmes inkuadrimit në një biznes familjar.

Sipas Tomew politikat e punësimit ndahen në dy lloje të politikave: pasive dhe aktive. Politikat pasive kanë për qëllim sigurimin e një standardi minimal të jetës për të papunët. Kjo nënkupton ndarjen e një shume të caktuar të parave që mbulon koston e jetesës për ata persona që kanë mbetur pa punë derisa të gjejnë punë. Kriteret për të përfutur një asistencë të tillë financiare duhet të jenë të rrepta dhe të rregulluara mirë. Politikat aktive, në anën tjetër, kanë për qëllim aktivizimin e punësimit duke ruajtur vendet e punëve ekzistuese, dhe duke inkurajuar krijimin e vendeve të reja të punës ose përmes vetëpunësimit. Politikat aktive zbatohen në disa forma: punësimi i subvencionuar - kur zyrat e punësimit të qeverisë punësojnë njerëz në programe publike; marrëdhëniet kontraktuale - kur qeveria nënshkruan kontratë me punëdhënësin i cili ofron punë; programet e trajnimit - kur të punësuarve u ofrohen programe trajnimi për ngritjen e shkathtësive, etj.

Tregu i punës dhe punësimit në Kosovë karakterizohet me një shkallë të lartë të papunësisë (30.9%), me një shkallë të ulët të punësimit (25.5%), me një shkallë shumë të lartë të popullsisë që janë në moshë pune por që nuk janë ekonomikisht aktiv (63.1%), me një shkallë të lartë të papunësisë së të rinjve (55.3%), me një shkallë shumë të ulët të punësimit të femrave (10.7%),² si dhe me

¹ Tomoev, L. & Meinardus, M., (2012). Employment Policies in South-East Europe - Common Challenges and Different Scenarios, FES: Bullgaria

² Agjencia e Statistikave të Kosovës: Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2012 në Kosovë

papunësi afatgjate ku 90% e të papunëve të regjistruar janë të papunë afatgjatë (mbi 12 muaj)³.

Shkalla e lartë e papunësisë në vazhdimësi e ka përcjellë Kosovën që nga paslufta. Për të krijuar vende pune dhe për të ulur nivelin e lartë të papunësisë, në vitin 2009 Qeveria e Kosovës përgatiti një strategji gjithëpërfshirëse, Strategjinë e Punësimit 2010-2012. Në këtë dokument të rëndësishëm 50 faqesh, Qeveria fillimisht përmend problemet që ndërlidhen me punësimin, sikurse pengesat për tërheqjen e investitorëve të huaj, problemet në sistemin e arsimit, trajnimit dhe aftësimin profesional, gjendjen në qendrat e regjistrimit të punëkërkuësve dhe elemente të tjera që kanë të bëjnë me punësimin. Në pjesën e dytë, strategjia përmend disa politika dhe masa për zhvillimin e ambientit të punësimit. Por, përkundër emrit që mban si strategji për punësim, ky dokument nuk përmban politika konkrete se sa vende pune synohen të krijohen gjatë periudhës trevjeçare 2010-2012 dhe si do të krijohen ato. Në të vërtetë, strategjia askund nuk përmend as përqindjen e papunësisë që synon ta ulë brenda periudhës tre vjeçare. Me fjalë të tjera, strategjisë i mungojnë objektiva të qarta, gjë që vështirëson edhe vlerësimin e efektit të saj.

Një dokument tjetër strategjik i Qeverisë së Republikës së Kosovës është edhe plani për zhvillimin ekonomik të vendit. Në këtë dokument strategjik, i njohur si “Plani i Veprimit i Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2013”, Qeveria parasheh rritje reale ekonomike vjetore prej 7-8% dhe ulje të personave të regjistruar si të pa punë prej 8-10% në vit. Edhe me këtë dokument strategjik problemi nuk qëndron vetëm tek shifrat ambicioze, por në atë se nuk është shumë specifik dhe nuk tregon saktësisht se si do të bëhet rritja ekonomike dhe krijimi i vendeve të reja të punës.

Ky studim ka për qëllim vlerësimin e efektit të Strategjisë së Punësimit 2010-2012. Pasi se shumë nga politikat e përmendura në këtë strategji janë të përgjithësuara, Instituti GAP ka analizuar vetëm ato politika që janë të matshme. Strategjia e Punësimit është krahasuar edhe me strategjinë e punësimit të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian. Në bazë të përvojave më të mira të shteteve të tjera dhe specifikave të Kosovës, studimi ofron edhe një varg rekomandimesh që duhet të merren parasysh gjatë përpilimit të strategjisë së ardhshme të punësimit.

³ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale: Raporti i Performances - Puna dhe Punësimi 2012

III. SHIFRAT KONTRADIKTORE RRETH PAPUNËSISË

Ekzistojnë tri institucione shtetërore që ofrojnë të dhëna rreth fuqisë punëtore në Kosovë dhe shkallës së punësimit. E para është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), e cila publikon raportin periodik që njihet si "Raporti i Performancës - Puna dhe Punësimi". E dyta është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), e cila publikon raportin "Anketa e Fuqisë Punëtore", si dhe Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës që me anë të raportit vjetor tregon shifrat e kontribuuesve aktiv dhe kontribuuesve/të punësuarve të rinj. Problemi me të dhënat që ofrohen nga këto institucione, sidomos të dhënat e MPMS dhe ASK-së, është se dallojnë shumë nga njëra tjetra. Ky mos unifikim i të dhënave shkakton probleme në propozimin e politikave të duhura sociale dhe krijon huti rreth gjendjes reale në terren. Një gjë e tillë është kritikuar edhe nga Raporti i Progresit 2013 i cili thotë se "të dhënat rreth tregut të punës janë të pakta dhe të çrregulluara"⁴. Megjithatë, te dy këto institucione, MPMS dhe ASK, në të dhënat që ofrojnë për vitin 2012 kanë një gjë të përbashkët: uljen e nivelit të papunësisë dhe punëkërkuësve të regjistruar, gjë që, siç do të shohim më vonë, është më shumë rezultat i ndërrimit të metodologjisë së llogaritjeve se sa i krijimit të hovshëm të vendeve të punës.

Agjencia e Statistikave të Kosovës - ka publikuar Anketën e Fuqisë Punëtore për çdo vit që nga viti 2001, duke ofruar të dhëna të vazhdueshme rreth shkallës së punësimit dhe papunësisë në Kosovë. Megjithatë, publikimi i këtij dokumenti ka pasur një shkëputje nga viti 2009 deri më 2012⁵. Kjo pauzë dy vjeçare nxjerr në pah dallime të mëdha sa i përket të dhënave rreth papunësisë. Përderisa në vitin 2009 ASK vlerësoi se shkalla e papunësisë ishte 45.4%⁶, në raportin për gjysmën e parë të vitit 2012, shkalla e papunësisë kishte rënë në 35.1%⁷. Ndërkaq, disa muaj më vonë ASK publikoi edhe raportin final i cili tregoi se shkalla zyrtare e papunësisë për vitin 2012 është 30.9%.⁸ Një krahasim matematikor mes këtyre shifrave lë të kuptosh se brenda tre viteve papunësia ka rënë nga 45% në 30.9%!

⁴ Komisioni Evropian: Raporti i Progresit për Kosovën 2013, f. 22

⁵ Sipas Kryeshefit të ASK, hulumtimi për vitin 2010 dhe 2011 nuk është mbajtur për shkak të mungesës së buxhetit. ASK: Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2012 në Kosovë, f. 4

⁶ Enti i Statistikës së Kosovës: Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2009

⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës: Anketa e Fuqisë Punëtore 2012 – Rezultatet për Gjysmën e Parë të Vitit 2012

⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës: Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2012 në Kosovë

Raporti final i ASK nxjerr në shesh dy të gjetura interesante. E para, raporti tregon se shkalla e popullsisë në moshë pune që nuk janë ekonomikisht aktivë⁹ ka arritur në 63.1%, që është gati dy herë më shumë se shkalla e popullsisë që është ekonomikisht aktive. Prej tyre 23.5% nuk kërkonin punë sepse besonin se nuk ka punë. Siç vërehet nga tabela në vazhdim kjo kategori e njerëzve nga viti 2009 është rritur dukshëm, gjë që tregon se mosbesimi i njerëzve në institucionet e punësimit është në rritje e sipër.



Tabela 1: Shkalla e popullsisë që nuk janë ekonomikisht aktiv sipas ASK

Elementi i dytë është se shkalla e papunësisë prej 30.9% dallon shumë nga shifrat e dala nga regjistrimi i popullsisë. Pra, nëse krahasohen të dhënat nga Anketa e Fuqisë Punëtore 2012 me të dhënat e dala nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë i kryer në prill të vitit 2011, e që të dy publikimet janë të bërë nga e njëjta organizatë (ASK), vërehen dallime të mëdha. Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë nga 1.252.248 banorë të Kosovës që janë mbi 15 vjeç, 508.100 e tyre janë popullatë ekonomikisht aktivë¹⁰. Nga ta, 280.454 persona janë të punësuar kurse 227.464 persona të tjerë konsiderohen të pa punë, gjë që nënkupton se shkalla e papunësisë ishte 44%.

Shifrën prej 30.9% ASK e ka nxjerrë duke ndryshuar kriteret për llogaritjen e fuqisë punëtore, e jo për shkak se ka pasur një punësim masiv në vend. Pra, papunësia në vend nuk ka ra nga 44% në 30.9% brenda një viti, sepse për të ndodhur kjo është dashur që

⁹ Popullatë ekonomikisht jo aktivë sipas ASK është ajo kategori e njerëzve që nuk janë të punësuar dhe nuk kanë qenë aktivë në kërkim të punësimit gjatë katër javëve të kaluara dhe nuk janë të gatshëm të fillojnë punën brenda dy javësh.

¹⁰ Popullatë ekonomikisht aktive sipas ASK është ajo kategori e njerëzve që janë të punësuar ose të papunësuar dhe po kërkojnë punë.

Kosova të ketë një rritje të hovshme ekonomike e cila do të shoqërohej me krijimin e shumë vendeve të punës, ndërkaq Kosova nuk ka pasur një rritje të hovshme ekonomike në tri vitet e fundit siç do të shpjegojmë më poshtë.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - ka publikuar Raportin e Performancës - Puna dhe Punësimi në mënyrë periodike që nga viti 2003. Ky raport në mes tjerash ofron të dhëna rreth numrit të punëkërkuësve të regjistruar pranë zyrave përkatëse për punësim. Sipas këtij raporti, në vitin 2011, gjithsej 325.261¹¹ persona ishin regjistruar si të pa punë nga Shërbimet Publike të Punësimit (SHPP), kurse në vitin 2012, numri i personave të regjistruar si të pa punë ishte 259.341¹². Kjo tregon se për një vit numri i të pa punëve ka rënë për 20%, apo me fjalë të tjera brenda një viti 65.920 persona janë ç’regjistruar nga lista e punëkërkuësve.

Shifrat tregojnë se gjetja e një vendi të punës në Kosovë është shumë e vështirë. Sipas të njëjtit raport të MPMS, mbi 90% e të papunëve të regjistruar në Kosovë janë të papunë afatgjatë, të cilët janë në kërkim të një vendi të punës për më shumë se një vit. Në anën tjetër, gjatë vitit 2012, shërbimet publike të punësimit kanë ofruar vetëm 9.434 vende të lira pune, prej të cilave 6.166 vende pune janë ofruar nga sektori privat. Kjo nënkupton se një vend i lirë pune ka qenë në dispozicion për 27 të papunë. Por, edhe pse janë ofruar 9.434 vende pune, janë punësuar vetëm 7.692 persona. Në të vërtetë, siç tregon edhe tabela në vijim, nga viti 2009 asnjëherë nuk janë plotësuar të gjitha vendet e ofruara të punës. Kjo mund të jetë si pasojë e kualifikimeve jo të duhura të punëkërkuësve.

¹¹ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale: Puna dhe Punësimi 2011

¹² Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale: Raporti i Performances - Puna dhe Punësimi 2012




Tabela 2: Numri i punëkërkesve të regjistruar dhe i vendeve të reja të punës

Andaj, largimi i mbi 65 mijë personave nga lista e punëkërkesve del të jetë më shumë si rezultat i reformave në sistemin e regjistrimit se sa i punësimit të tyre. Pra, shumë punëkërkes janë larguar nga lista pas implementimit të programit kompjuterik SIMP, i cili bën azhurnimin e listës së punëkërkesve. Sipas rregullave të reja personi i regjistruar si i pa punë nëse nuk konfirmon statusin e tij brenda çdo gjashtë muaj, largohet automatikisht nga lista dhe konsiderohet si punëkërkes pasiv¹³.

Të dhënat nga Trusti - janë një burim tjetër për të llogaritur përafërsisht numrin e punësimeve brenda një viti, edhe pse për shkak të shkallës së lartë të informalitetit në Kosovë, ku sipas MPMS rreth 30% e bizneseve në Kosovë veprojnë në ekonominë joformale¹⁴, është vështirë të dihet saktë numri i përgjithshëm i personave që punësohen për çdo vit në Kosovë. Megjithatë, të dhënat nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës ofrojnë një mundësi për të parë se sa kontribut-pagues të rinj shtohen çdo vit, ndonëse edhe vet Trusti tërheq vërejtjen se të dhënat e ofruara nuk pasqyrojnë një pamje reale mbi punësimin në Kosovë, për shkak të informalitetit¹⁵. Çdo person i punësuar në Kosovë ligjërisht është i obliguar që të kontribuojë në fondin e kursimeve pensionale që

¹³ Bisedë me z.Hafiz Leka nga MPMS më 19.09.2013

¹⁴ Uebfaqja e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, shikuar më 15 gusht 2013, <http://mpms.rks-gov.net/sq-al/departamentet/departamentiipun%C3%ABsdhepun%C3%ABsimit/divizioniipun%C3%ABsimit.aspx>

¹⁵ Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: Raporti Vjetor 2012, f.24

menaxhohet nga Trusti. Gjatë vitit 2012, numri i kontribuuesve aktiv në Trust ishte 266.026 persona, që përfshinë personat e punësuar, të vetëpunësuar dhe të të dyjave. Ajo që vlen të përmendet është se në vitin 2012 kishte 9.879 kontribuues më shumë se për vitin 2011, por nuk ka të dhëna për të konkluduar nëse kjo rritje vjen për shkak të rritjes së punësimit, qoftë ai sezonal ose jo, apo për shkak të rënies së informalitetit¹⁶.




Tabela 3: Numri i kontribuuesve aktiv dhe të rinj në Trust

Sidoqoftë, në bazë të të dhënave të Shërbimit Publik të Punësimit dhe të dhënave nga Trusti, del se gjatë vitit 2012 në Kosovë nuk janë punësuar më shumë se 10.000 persona. Në rastin e Kosovës krijimi i jo më shumë se 10.000 vendeve të punës në vit është i pamjaftueshëm për ta zvogëluar shkallën e lartë të papunësisë.

¹⁶ Ibid. f.26

IV. DOKUMENTET STRATEGJIKE QEVERTARE PËR PUNËSIM

Qeveria e Republikës së Kosovë ka hartuar dy strategji për zhvillimin ekonomik të vendit dhe për ngritjen e shkallës së punësimit. Dokumenti strategjik i Qeverisë së Kosovës i njohur si “Plani i Veprimit i Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014”, parasheh rritje reale ekonomike vjetore prej 7-8% në vit dhe ulje të numrit të personave të regjistruar si të papunë prej 8-10% në vit. Ky dokument përmban pesë shtylla se si Qeveria synon të arrijë rritjen ekonomike:

- a) Ruajtja e qëndrueshmërisë makrofiskale;
- b) Investimet, mjedisi investues dhe përkrahja e sektorit privat;
- c) Zhvillimi i infrastrukturës publike;
- d) Rivitalizimi i sektorit të bujqësisë;
- e) Zhvillimi i kapitalit njerëzor.

Në një vlerësim të shkurtër, mund të themi se nuk ka pasur rritje ekonomike prej 7-8% në vit siç e ka paraparë Qeveria në këtë dokument. Sipas të dhënave nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), rritje ekonomike vjetore nuk është arritur as sa gjysma e përqindjes së paraparë. Në raportin për vlerësimin tremujor të ekonomisë, BQK tregon se rritja reale e PBB-së për vitin 2012 ishte 2.9%¹⁷, kurse sipas Bankës Botërore rritja reale për vitin 2012 ishte 3.8%, që megjithatë është larg objektivave të Qeverisë. Edhe Raporti i Progresit 2013 vlerëson se rritja ekonomike është dobësuar dhe mbetet e brishtë. Ndërkaq ulja e numrit të personave të regjistruar si të papunë prej 8-10% në vit mund të themi se ka ndodhur, madje në një shkallë prej 20%, por vetëm duke larguar mbi 65 mijë veta nga lista, si rezultat i azhurnimit të listës së punëkërkuësve.

Edhe pse ky studim është kufizuar vetëm në analizimin e “Strategjisë së Punësimit 2010-2012”, mund të thuhet se objektivat e këtyre dy strategjive janë të përafërta, andaj dështimi për të zbatuar një të strategji mund të ndikojë negativisht edhe tek tjetra.

Dokumenti tjetër strategjik i Qeverisë së Republikës së Kosovës “Strategjia e Punësimit 2010-2012”, është miratuar në mbledhjen e qeverisë më 23 dhjetor 2009¹⁸. Menaxhimi i kësaj strategjie përfshinte gjithsej pesë ministri të ndryshme dhe vetë Zyrën e

¹⁷ Banka Qendrore e Kosovës: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë, Nr.2, Tremujori 1/2013, http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2013/BQK_TM1%202013.pdf

¹⁸ Shih më shumë rreth këtij vendimi në uebfaqen e GAP Monitor te Institutit GAP, <http://gapmonitor.org/?id=2&n=267>

Kryeministrit, kurse implementimi i politikave të saj kap një kosto preliminare prej rreth 104 milion euro.

Në këtë strategji, Qeveria bën një prezantim të përgjithshme të tregut të punës, ofron të dhëna rreth shkallës së punësimit dhe papunësisë, si dhe përmend problemet kryesore të tregut të punës në vend. Pjesa kryesore e këtij dokumenti, apo vetë strategjia për krijimin e vendeve të punës, përmban tri politika zhvillimore:

- a) Përmirësimi i klimës së investimeve dhe ulja e kostos së biznesit, duke inkurajuar hapjen dhe zgjerimin e firmave;
- b) Zhvillimi i kapitalit njerëzor përmes arsimit formal dhe trajnimit profesional;
- c) Përmirësimi i funksionimit të tregut të punës.

Këto janë tri politikat afatgjate që sipas Qeverisë do të qonin drejt përmirësimit të ambientit të punësimit në vend. Por, për të krijuar vende pune sa më shpejtë që është e mundur, kjo strategji përmend dy plane, planin afatshkurtër dhe afatmesëm. Sipas planit afatshkurtër Qeveria do të zgjerojë investimet publike dhe programet e punëve publike, ku me investime publike nënkupton ndërtimin e projekteve të mëdha infrastrukturore, ndërsa me punët publike ndërtimin e pasurive të rëndësishme në nivel lokal. Kurse në planin afatmesëm, strategjia synon të krijojë vende të punës duke reformuar sektorët e energjisë dhe minierave dhe duke promovuar zhvillimin e ndërmarrjeve.

V. MANGËSITË KRYESORE TË STRATEGJISË

Para se t'i analizojmë tri politikat zhvillimore të strategjisë, duhet theksuar se strategjia për punësim ka të paktën katër mangësi.

Nuk përmban objektiva të matshme - Mangësia e parë e kësaj strategjie është se as në planin afatshkurtër dhe as në atë afatmesëm, ajo nuk përmend shifra të vendeve të punës që do të krijohen nga viti në vit. Megjithatë, në mënyrë të përgjithësuar në një fusnotë thuhet se për t'u siguruar se përqindja e të papunëve nuk do të rritet, rreth 15.000 vende të reja pune neto duhet të krijohen në vit nga ekonomia. Ndërsa, në planin afatmesëm, strategjia thotë se duhet të krijohen vende pune aq sa numri neto i vendeve të krijuara të punës e tejkalon numrin e individëve që hynë në tregun e punës.

Në anën tjetër, në strategji thuhet se brenda pesë viteve të ardhshme rreth 200.000 persona do të arrijnë moshën e punësimit,

prej të cilëve 110.000 do të hyjnë në tregun e punës¹⁹. Kjo nënkupton se mesatarisht 22.000 persona në vit i shtohen tregut të punës në Kosovë. Nëse strategjia parasheh që numri i krijuar i vendeve të punës të tejkalojë numrin e individëve që hynë në tregun e punës, i bie që duke filluar nga viti 2010, kur ka filluar së implementuari strategjia, Qeveria është dashur të krijojë pak më shumë se 22.000 vende pune për çdo vit, apo të paktën 66.000 vende pune për periudhën 2010-2012. Një gjë e tillë, të paktën në ekonominë formale, nuk është arritur siç e cekëm më lartë.

Nuk ofron shpjegime të projekteve për punësim - Strategjia e punësimit përveç se nuk është e matshme në aspektin kuantitativ, edhe në aspektin kualitativ nuk përmban sqarime të bollshme. Pra, mangësi tjetër është se strategjia nuk ka sqaruar në mënyrë të detajuar se çfarë aktivitete do të ngërthejnë në vete investimet publike dhe programet e punëve publike. Megjithatë, me investime publike strategjia lë të kuptohet se fjala është për ndërtimin e projekteve të mëdha infrastrukturore. Projekti më i madh infrastrukturor në vitet e fundit është ndërtimi i "Autostradës Ibrahim Rugova". Ky projekt tre vjeçar ka filluar në prill 2010 dhe ka përfunduar në nëntor 2013. Megjithëse në këtë projekt janë punësuar një numër i konsiderueshëm i punëtorëve kosovar²⁰, problemi kryesor është se ky projekt i është dhënë dy kompanive të huaja të cilat kapitalin kryesor e bartin në shtetet e tyre përkatëse. Pra, në investimin e Qeverisë së Kosovës në këtë projekt me vlerë mbi 800 milion euro, vetëm një pjesë e vogël është shpenzuar për punësimin e kosovarëve dhe nën-kontraktimin e firmave vendore. Problemi tjetër është se këto punësime janë sezonale dhe jo afatgjate.

Ndërkaq, programet e punëve publike, edhe pse nuk janë të detajuara në strategjinë e punësimit, nuk kanë munguar gjatë tri viteve të fundit. Këto projekte, që kryesisht zbatohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kanë ndikuar në punësime sezonale të punëkërkuësve të regjistruar. Në vazhdim do të përmendim disa nga këto projekte.

Berza e punësimit është një projekt i përbashkët i MPMS dhe Aleancës Kosovare të Biznesit (AKB) që ka për qëllim organizimin e panairit në disa qytete të Kosovës ku punëdhënësit shpalosin ofertat e tyre për punësim. Nga viti 2010 deri në vitin 2012 janë ndërmjetësuar për punësim dhe aftësim gjithsej 2.781 persona. Ajo

¹⁹ Qeveria e Republikës së Kosovës: Strategjia e Punësimit 2010-2012, f.7

²⁰ Sipas zëdhënëses së Bechtel/Enka gjithsejtë 11.579 punonjës lokal kanë punuar në ndërtimin e autostradës nga muaji prill 2010 dhe pagesa e tyre është në bazë të orëve të punës. Përgjigje e dhënë përmes email-it për Institutin GAP më 17.09.2013

që vlen të theksohet për këtë projekt, që megjithatë është mjaft i kushtueshëm, është se asnjëherë nuk arrihet të plotësohet numri i punëve të ofruara me gjithë numrin e madh të papunësisë në vend. Ky është një indikator se sistemi i shkollimit në vend nuk përgatit kuadro të përshtatshëm për kërkesat e tregut të punës.

Projekt tjetër është edhe programi për punësimin e studentëve në Gjermani. Punësimi kryesisht zgjatë tre muaj dhe punët ofrohen në sektorin e turizmit, gastronomisë, pastrimit, bujqësisë, etj. Gjatë viteve 2010-2012, gjithsej 837 studentë kanë përfituar nga ky program. Projekte të tjera që janë zhvilluar gjatë vitit 2012 janë “Pastrimi i pyjeve” ku janë angazhuar 1.620 punëkërkues, projekti “Kosova e bukur” ku janë angazhuar 911 punëkërkues, projekti “Mbrotja e pyjeve nga zjarret” ku janë angazhuar 61 punëkërkues, etj²¹. Përparësia e këtyre projekteve është se kanë aktivizuar një numër të punëkërkuesve, por natyra e këtyre angazhimeve është e përkohshme dhe jo punësim i qëndrueshëm dhe afatgjatë. Në përgjithësi, Qeveria e Kosovës dhe komunat nuk kanë mbajtur ndonjë evidencë se sa njerëz janë punësuar përkohësisht nga kompanitë private me rastin e kryerjes së punëve publike.

Agrikultura nuk përmendet fare - Mangësia e tretë e strategjisë së punësimit është se as në planin afatshkurtër dhe as në atë afatmesëm nuk e përmend agrikulturën si një mundësi për zhvillim dhe krijim të vendeve të punës²². Strategjia nuk përmban politika stimuluese për kultivim të tokës apo të mbajtjes së bagëtive, përkundër faktit se shumica e familjeve në Kosovë posedojnë tokë. Sipas ASK-së, nga 297.090 ekonomi familjare që ekzistojnë në Kosovë, 195.124 e tyre posedojnë tokë. Prej tyre, 61% nuk e kultivojnë aspak tokën. Përveç që nuk e kultivojnë tokën, shumica e tyre nuk posedojnë as bagëti. Saktësisht vetëm 30% e ekonomive familjare posedojnë bagëti (lopë, dele, pula, etj)²³. Rreth 50% e popullsisë jetojnë në vende rurale, dhe sikur të investonin në agrikulturë kjo do të ndikonte pozitivisht edhe në uljen e papunësisë në vend.

Mungojnë mekanizmat stimules financiar - Mangësia e katërt e strategjisë është se nuk parasheh ndonjë mekanizëm për stimulimin e vetë-punësimit, nuk parasheh grante për themelimin apo zgjerimin e ndërmarrjeve të vogla, nuk përmban stimules financiar për rritjen e numrit të punëtorëve tek ndërmarrjet e

²¹ Shih raportet Puna dhe Punësimi 2012, 2011 dhe 2010 të MPMS

²² Rivalizimi i sektorit të bujqësisë përmendet në Vizionin Ekonomik të Kosovës por jo edhe në Strategjinë e Punësimit

²³ Agjencia e Statistikave të Kosovës: Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011– Rezultatet Përfundimtare

mesme dhe të mëdha, nuk ka stimulues për punësimin e grupeve të marginalizuara në Kosovë sikurse komuniteti RAE, familjet e dëshmorëve, dhe grave në përgjithësi, apo stimulues për ofrimin e trajnimeve dhe praktikës për punëkërkuarit dhe nuk nxit kalimin e firmave nga ekonomia joformale në atë formale. Një strategji e punësimit, sikurse do të shohim më poshtë tek shembujt e shteteve të rajonit, do duhej të ofronte stimulues financiar ose përfitime të tjera fiskale për të gjitha kompanitë private që do të ndihmonin në rritjen e punësimit në një vend me shkallë shumë të lartë të papunësisë dhe ekonomikisht joaktive.

VI. VLERËSIMI I STRATEGJISË SË PUNËSIMIT

Strategjia e Punësimit konstaton se krijimi i vendeve të punës është një sfidë afatgjate. Megjithatë, për ta tejkaluar këtë sfidë, strategjia parasheh implementimin e politikave që kanë të bëjnë me përmirësimin e klimës së investimeve, përmes ngritjes së nivelit të arsimit dhe trajnimit profesional, si dhe përmes përmirësimit të funksionimit të institucioneve të punës. Në vazhdim do të bëjmë një vlerësim të këtyre tri politikave zhvillimore.

Politikat për përmirësimin e klimës së investimeve për të mundësuar hapjen dhe zgjerimin e firmave – kjo pjesë e strategjisë përmend pesë probleme të cilat duhet të adresohen për të përmirësuar klimën e investimeve në vend e që janë: a) investimet në infrastrukturën e bizneseve; b) qasja në financa dhe kostoja e financimit; c) përmirësimi i kornizës ligjore dhe rregullative për bizneset; ç) informatat e dobëta të tregut dhe baza e dobët e shkathtësive për bizneset e vogla; d) përforcimi i kapaciteteve institucionale.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ka ndërmarrë një sërë masash në përmirësimin e legjislacionit dhe politikave sa i përket zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ndër to hynë edhe ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për zonat ekonomike dhe Ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM). Në vazhdim, si dokument strategjik është hartuar edhe Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve në Kosovë²⁴. Po ashtu është zgjeruar numri i bizneseve në Parkun e Biznesit në Drenas dhe krijimi i zonës ekonomike "Parku i Biznesit Mitrovicë".

Në një hulumtim të bërë nga MTI rreth qasjes së NVM-ve në financa është gjetur se disa nga problemet kryesore që NVM-të kanë në qasje në financa janë²⁵:

- a) mungesa e prezantimit të propozimeve të planifikuara mirë;
- b) mbajtja e regjistrave financiare të dyfishtë si tendence për shmangie të taksave;
- c) mungesa e ndonjë kolaterali tjetër përveç apartamenteve të banimit;
- d) mungesa e ndonjë agjencioni për mbledhjen e borxheve të bankave;
- e) normat e larta të interesit.

²⁴ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë: Raporti Vjetor 2012

²⁵ Access to Finance, Ministry of Trade and Industry, shtator 2012
http://www.smallbusinessdays.com/images/uploads/28.09.2012_Access_to_finance.pdf

Kur jemi te normat e interesit, Kosova ka marginën më të lartë të interesit (normat në kredi minus normat në depozita) në rajon²⁶. Në bazë të statistikave të BQK-së, norma mesatare efektive e interesit në dhjetor 2012 ka qenë 12.7%, ndërsa margjina e interesit ishte 9.1%. Gjate vitit 2012, ishin lëshuar kredi ndaj ndërmarrjeve me vlerë prej 1.2 miliard euro mirëpo norma e rritjes së kreditimit ndaj këtij sektori ishte ngadalësuar nga 8% në 4%. Ky ngadalësim kishte ardhur përkundër rritjes së kërkesës për kredi nga NVM-të²⁷.

Një hap shpresëdhënës sa i përket përmirësimit të qasjes së ndërmarrjeve private në financa është anëtarësimi i Kosovës në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në dhjetor 2012. BERZH-i deri më tani ka investuar rreth 70 milionë euro në Kosovë. Mënyra e financimit të BERZH-it bëhet përmes huadhënies, asistencës teknike apo pjesëmarrjes me kapital. Duhet cekur se 96% e investimeve të BERZH-it në Kosovë janë bërë në sektorin privat.

Megjithatë, problem mbetet konkurrenca jo e ndershme ndërmjet ndërmarrjeve të vogla, ku vetëm një numër i vogël paguan tatime ndërsa pjesa më e madhe nuk e bëjnë këtë. Në vitin 2011 nga gjithsejtë 100.770 ndërmarrje të regjistruara në Kosovë, vetëm 18.170 prej tyre deklarorin tatime pranë Administratës Tatimore të Kosovës (ATK)²⁸. Pra 82% e firmave nuk paguanin tatime. 98.4% e kompanive të regjistruara janë mikro-kompani me 1-9 punëtorë, 1.4% janë kompani të vogla me 10-49 punëtor dhe vetëm 0.2% janë kompani të mesme me 50-249 punëtor²⁹.

Problem tjetër është edhe rënia drastike e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në vitin 2012. IHD-të në Kosovës për vitin 2012 ishin 232 milion euro ose 41.2% më të ulëta se sa në vitin 2011 kur arrinin vlerën prej 394 milion euro. Në vitin 2012, Turqia paraqet vendin prej nga më së shumti kanë ardhur IHD-të, kurse sektorët ku më së shumti janë investuar janë patundshmëria (31%), ndërtimtaria (28%), prodhimtaria (12%), sektori financiar (10%), dhe sektori i transportit dhe telekomunikacionit (7.9%)³⁰.

Në bazë të Raportit të Bankës Botërore rreth "Të Bërit Biznes 2014", Kosova ka shënuar përparim në heqjen e barrierave në të bërit

²⁶ Instituti GAP, Bankometri Nr. 8, qershor 2013

²⁷ Banka Qendrore e Kosovës: Raporti i Stabilitetit Financiar 2012, <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2012/Raporti%20i%20Stabilitetit%20Financiar.pdf>

²⁸ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë: Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, [http://www.mti-ks.org/repository/docs/2013_MTI_Strategjia_ZHSP_Shq_\(2\)_806808.pdf](http://www.mti-ks.org/repository/docs/2013_MTI_Strategjia_ZHSP_Shq_(2)_806808.pdf)

²⁹ Ibid.

³⁰ Banka Qendrore e Kosovës, Raporti Vjetor 2012, f. 81

biznes. Këtë vit, Kosova është renditur në vendin e 86-të nga gjithsej 189 shtete. Në përgjithësi progresi më i madh është shënuar në hapjen e biznesit, marrjen e lejes së ndërtimit dhe regjistrimin e pronës. Si pjesë e reformave deri më tani janë hapur 26 "one-stop-shops" nëpër komunat e Kosovës³¹.

Por, me gjithë përmirësimet, ende mbesin edhe shumë sfida për tu adresuar. Raporti i Progresit 2013 vlerëson se në mënyrë që të përmirësohet ambienti i biznesit duhet të merren masa të mëtutjeshme në sundimin e ligjit, sigurimin e konkurrencës së drejtë dhe luftimin e korrupsionit.

Masat e politikave në arsim, shkathtësi dhe trajnim – sipas strategjisë, arsimi profesional dhe trajnimi kanë për qëllim ndërtimin e shkollave të kompetencës, zgjerimin e mundësive për arsim dhe aftësim të të rriturve, vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, etj.

Në tri vitet e fundit janë ndërtuar disa shkolla të kompetencës, edhe pse në strategji nuk specifikohet se në cilat komuna do të ndërtohen ato. Shkollat, që janë ndërtuar deri më sot ose kanë filluar së ndërtuari, janë kryesisht një bashkëpunim mes MASHT dhe ambasadave të huaja në Kosovë të cilat kanë ndihmuar financiarisht këto projekte. Vetëm Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë ka ndihmuar në ndërtimin e dy shkollave të kompetencës, atë në Malishevë dhe atë në Skenderaj. Shkolla e mesme profesionale në Skenderaj edhe pse konsiderohet ndër shkollat më moderne në rajon nuk ka arritur të mbushet me nxënës, pasi se në të vijojnë vetëm 364 nxënës kurse ka një kapacitet për 850 nxënës.³²

Sukses është shënuar sa i përket miratimit të dy ligjeve që kanë të bëjnë me këtë fushë, Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur dhe Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional. Edhe në aspektin e akreditimit, bartësit e arsimit të lartë i janë nënshtruar disa herë procesit të akreditimit. Tashmë një numër i madh i tyre kanë marrë akreditim për periudhën pesë vjeçare, gjegjësisht deri më 2018.

Megjithatë, investimi në arsim, shikuar nga ndarjet buxhetore, nuk ka qenë prioritet i Qeverisë së Republikës së Kosovës në tri vitet e fundit. Nëse marrim shifrat e investimeve publike në arsim (duke përjashtuar grantet nga donatorët), shohim së vetëm 2% e

³¹ World Bank: Doing Business 2014, Economy Profile: Kosovo, <http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/~media/giawb/doing%20business/documents/profiles/country/KSV.pdf?ver=2>

³² Avdyl Beqiri, "Shkolla më moderne me pak nxënës", Gazeta Jeta në Kosovë, <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,1599>

investimeve kapitale në vitin 2012 janë investuar në arsim.³³ Në bazë të grafikut të mëposhtëm shohim se buxheti total për arsim ishte rritur në mënyrë më të theksueshme në vitin 2011, mirëpo kjo kishte ardhur si rezultat i rritjes së pagave në nivel vendi, e jo të ndonjë investimi apo plani serioz për arsimin.




Figura 1: Trendet e shpenzimeve për arsim

Masat e politikave lidhur me institucionet e punës – ndër masat e parapara në këtë fushë janë reforma dhe modernizimi i shërbimeve të punësimit publik, themelimi i një sistemi të besueshëm informativ për tregun kombëtar të punës, mbështetja e migrimit të fuqisë punëtore, zgjerimi i programeve të tregut aktiv të punës, mbrojtja e punësimit dhe lëvizja e individëve nga asistenca sociale në punë.

Modernizimi i shërbimeve të punësimit është arritur në një masë të duhur me implementimin e programit të quajtur Sistemi i Informimit për Menaxhimin e Punësimit (SIMP), i cili shërben si mekanizëm për menaxhimin e të dhënave rreth papunësisë, punëkërkesve, punëdhënësve dhe ofruesve të trajnimeve. Vënia në funksion e këtij sistemi vlerësohet pozitivisht edhe nga Raporti i Progresit 2013. Megjithatë Strategjia parasheh që me sistemin e ri të ofrohen shërbime edhe për punësim online, kjo gjë ende nuk është arritur.

Reformimi i shërbimeve të punësimit publik (SHPP) parasheh që SHPP të transformohet nga një organ administrativ në shërbim kombëtar të punësimit, gjegjësisht në Agjenci Kombëtare të

³³ Ministria e Financave: Raporti Vjetor Financiare Buxheti i Republikës së Kosovës 2012, 2011, 2010

Punësimit. Kjo agjenci deri më tani nuk është krijuar, madje as Ligji për agjencinë e punësimit ende nuk është miratuar në Kuvend.

Lëvizja e individëve nga asistenca sociale në punë është një objektivi tjetër i strategjisë. Numri i familjeve që përfitojnë nga skema e ndihmës sociale luhatet përgjatë vitit dhe nga viti në vit. Kështu për shembull, në janar 2012 numri i përfituesve në gjithë territorin e Kosovës ishte 35.159 familje, kurse në dhjetor 2012 ky numër kishte rënë në 31.111 familje³⁴. Njëjtë kishte ndodhur edhe në vitin 2011. Një rënie e tillë ndodh për shkak të angazhimit të familjarëve të aftë për punë në projektet e punëve publike që realizon MPMS nëpër Kosovë. Këto familje gjatë kohës sa zgjat projekti largohen nga skema sociale, kurse me të përfunduar projekti kthehen prapë në skemë³⁵. Pra, largimi nga skema sociale në shumë raste bëhet vetëm përkohësisht sepse projektet e punësimit janë të përkohshme. Andaj, nga viti 2009 numri i familjeve shfrytëzuese të skemës sociale ka mbetur pak a shumë i njëjtë siç tregon tabela më poshtë.

Tabela 4: Numri i familjeve përfituese të skemës sociale sipas ASK

Viti Rajoni	2009	2010	2011	2012 ³⁶
Prishtina	9.261	9.865	9.559	7.903
Gjilani	6.189	6.047	5.992	5.878
Prizren	3.745	4.690	4.706	3.500
Peja	6.737	6.093	5.842	5.985
Mitrovica	9.722	9.096	8.768	7.845
Gjithsej	35.656	35.791	34.867	31.111

³⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës: Statistikat e Mirëqenies Sociale 2012, http://esk.rks-gov.net/statistikat-e-mireqenies-/publikimet/doc_view/987-statistikat-e-mireqenies-sociale-2012?tmpl=component&format=raw

³⁵ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale: Aktiviteti i MPMS-së për vitin 2011, http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Librat/Broshura_al_2011.pdf

³⁶ Këto të dhëna paraqesin numri e familjeve përfituese për muajin dhjetor 2012, që dallon dukshëm nga muajt të tjerë.

VII. SHEMBUJ TË STRATEGJIVE PËR PUNËSIM

Duke pasur parasysh se papunësia është një problem madhor dhe zgjidhja e tij kërkon një qasje sistematike dhe konkrete, edhe shtetet tjera në rajon kanë përpiluar strategjitë e tyre të punësimit. Në vazhdim do të shohim elementet kryesore të dokumenteve strategjike të punësimit të Shqipërisë, Maqedonisë dhe atë të Bashkimit Evropian.

Shqipëria: Strategjia Sektoriale e Punësimit 2007-2013 –

Objektivi kryesor i saj është që deri në vitin 2013 të ulë nivelin e papunësisë në nivelin e papunësisë së vendeve të BE-së. Për ta arritur këtë, strategjia parasheh uljen e nivelit të papunësisë me 0.3% çdo vit, rritja e të punësuarve me 5% çdo vit dhe 20% e të regjistruarve si të pa punë të marrin pjesë brenda vitit 2013 në një program aktiv të trajnimit për punë.

Në kuadër të programeve aktive të punësimit, Strategjia parasheh ngritjen e cilësisë së Shërbimit Kombëtar të Punësimit si institucion që zbaton politikat e punësimit me një rrjet prej 36 zyrash të punësimit dhe një staf prej 372 punonjësish. Në këtë aspekt, strategjia synon që të rris numrin e punonjësve që ofrojnë shërbime për të papunët prej 47% në 55%. Në vendet e BE-së kjo përqindje është në masën 62-65%³⁷. Synim tjetër është edhe ndërtimi i një sistemi modern të shërbimeve të punësimit. Në Shqipëri funksionojnë edhe 14 agjenci private të punësimit, shërbime që bëjnë vlerësimin e kërkesave dhe të aplikimeve për punësim brenda dhe jashtë vendit. Strategjia synon që të rris bashkëpunimin e tyre me shërbimin publik të punësimit.

Strategjia parasheh aplikimin e pesë programeve shtetërore për nxitjen e punësimit sipas skemës së më poshtme:

1. Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve: Punëdhënësit që punësojnë përkohësisht (3-6 muaj) punëkërkues, mund të përfitojnë financim mujor të pagës së tyre deri në 100% të pagës minimale si edhe shpenzimet për sigurimet shoqërore të përfituesve. Nëse përfituesit punësohen për një periudhë deri në një vit dhe nëpërmjet kontratave të rregullta, punëdhënësi ka të drejtën të përfitojë një financim mujor të barabartë me shumën e një page minimale.

³⁷ Republika e Shqipërisë - Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta: Strategjia Sektoriale e Punësimit 2007-2013, http://www.dsd.gov.al/dsd/pub/strategjia_punesim_162_1.pdf

2. Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë: ky program mbështet financiarisht punëdhënësit që sigurojnë trajnimin e përfituesve dhe që punësojnë një pjesë të të trajnuarve të paktën për një vit. Qeveria e ndihmon financiarisht punëdhënësin në lidhje me pagën dhe kontributin e sigurimeve shoqërore gjatë nëntë muajve të trajnimit. Pas përfundimit të kurseve të trajnimit, punëdhënësi është i detyruar të punësojë 40% të të trajnuarave.
3. Programi për nxitjen e punësimit nëpërmjet formimit institucional: Zyrtarët e punësimit caktojnë dhe sigurojnë trajnimin për përfituesit nga ato kompani që garantojnë punësimin pas përfundimit të trajnimit. Ata përfitues që refuzojnë të marrin pjesë në këto kurse hiqen nga lista e punëkërkuesve të papunë dhe u ndërpritet pagesa e papunësisë.
4. Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra synon të integrojë në tregun e punës gra të marginalizuara si gratë të reja, gra të trafikuar, gra të moshuara dhe gra invalide. Ky program zgjat nga një deri në tre vjet. Gjatë vitit të parë, punëdhënësi mund të përfitojë 75% të financimit për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe 4 paga minimale. Gjatë vitit të dytë, punëdhënësit marrin 85% të kontributit për sigurimet shoqërore dhe 6 paga minimale dhe gjatë vitit të tretë ata marrin 100% të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe 8 paga minimale.
5. Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet përfshirjes së tyre në programet e praktikave profesionale në institucione/ndërmarrje, publike apo private. Punëdhënësit publik janë të detyruar t'i marrin falas në mjediset e tyre këta punëkërkues, në raport me personelin e administratës, sipas skemës: për çdo 50 veta personel – 1 praktikant. Për punëdhënësit privatë, që pranojnë në mjediset e tyre punëkërkues të papunë, të përfshirë në këtë program, përfitojnë një financim mujor nga zyra përkatëse e punësimit, në masën 100% të nivelit bazë të pagesës së papunësisë, për çdo muaj praktikë të punëkërkuesit.

Për secilin program Qeveria së bashku me donatorë të tjerë ndërkombëtar ndajnë buxhet të veçantë ku madhësia e buxhetit varet nga efikasiteti i programit pas analizës që u bëhet secilit program në fund të vitit. Më tej Strategjia Sektoriale e Punësimit flet

edhe për punësimin e disa grupeve më të ndjeshme si komuniteti rom, femrat, emigrantët, etj. Strategjia synon edhe përmirësimin e klimës së bizneseve dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) duke ua lehtësuar barrën fiskale që përfshinë:

- Reduktimin e tatimit në fitim për kompanitë nga 23% në 20%;
- Reduktimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël nga 3% në 1.5% dhe reduktimin e taksës vendore mbi biznesin e vogël në masën 50%;
- Heqjen e tatimit mbi vlerën e shtuar për librin në shtëpitë botuese dhe për reklamat;
- Uljen e çmimit të energjisë elektrike rreth 30% për bizneset.

Maqedonia: Strategjia Kombëtare e Punësimit 2011-2015 –

kjo strategji paraqet politikat e tregut të punës të cilat janë në harmoni me Strategjinë Ekonomike Evropiane “Evropa 2020”, dhe ka për qëllim të ofrojë masa specifike për uljen e papunësisë së strukturuar, zhvillimin e një fuqie punëtore që është në përputhje me kërkesat e tregut të punës, adoptimin e një sistemi për edukim dhe trajnim si dhe luftimin e ekonomisë joformale³⁸. Më konkretisht, kjo strategji synon arritjen e këtyre objektivave përmes programeve të më poshtme:

- Programi shtesë i punësimit me një grant prej 1.500 euro për çdo person të ri të papunë, ose në total 450 punësime të reja për periudhën 2011-2015 në firmat që janë të regjistruara me mekanizma të vetëpunësimit;
- Programi për përgatitje për punësim përmes trajnimeve, rrikualifikimeve apo më shumë kualifikim për personat e papunësuar, me qëllim të pajisjes me njohuri dhe shkathtësi;
- Programi i trajnimit për disa profesione që janë deficitare në tregun e punës. Në vitin 2011, një pilot program është zhvilluar për 800 persona të rinj për nevojat e industrisë së tekstilit;
- Projekti: “1.000 punësime shtesë” duke u ofruar kredi apo grante bizneseve me masa të vetë-punësimit. Më saktësisht, çdo punësim i ri do të kreditohet me një fond prej 3.000 euro për 4 vite, një vit pa pagesë dhe tre vite si periudhë për kthim të borxhit me 1% interes;
- Projekti: “Vetë-punësimi i 3.750 personave” me një kredi prej 3.000 eurove. Periudha e kthimit 4 vjeç me 1% interes kurse viti i parë pa pagesë;

³⁸ Qeveria e Republikës së Maqedonisë: Politikat Sociale <http://vlada.mk/node/268?language=en-gb>

- Projekti: “Formalizimi i 1.250 bizneseve”. Do të mbështetet çdo vend pune me 3.000 euro për ta formalizuar biznesin joformal, në mënyrë që të ulet ekonomia joformale;
- Projekti: “3.750 nga ideja deri tek biznesi i vetë-punësimit me 3.000 euro grante.” Ky projekt synon vetë-punësimin e personave deri në 27 vjeç, gratë viktima të dhunës së brendshme, gratë e papunësuara, ushtarët me karrierë që kanë mbaruar shërbimin në Ushtrinë e Republikës së Maqedonisë, etj.
- Subvencionimi i punësimit të 150 fëmijëve bonjak gjatë viteve 2011-2015 me një mbështetje financiare mujore prej 15.000 denar (243 euro) për një periudhë prej 6 muajsh, ku punëdhënësi është i obliguar që t’i mbajë ata të punësuar për të paktën 12 muaj të tjerë;
- Subvencionimi i punësimit të 400 prindërve të vetëm (single parents) me një mbështetje financiare mujore prej 15.000 denar (243 euro) për një periudhë prej 6 muajsh, ku punëdhënësi është i obliguar që t’i mbajë ata të punësuar për të paktën 12 muaj të tjerë;
- Subvencionimi i punësimit të 600 personave të moshuar mes 55-62 vjeç me një mbështetje financiare mujore prej 15.000 denar (243 euro) për një periudhë prej 6 muajsh, ku punëdhënësi është i obliguar që t’i mbajë ata të punësuar për të paktën 12 muaj të tjerë.

Subvencione të tilla parashihen edhe për ata që kanë kryer shërbimin ushtarak, pastaj personat që janë viktima të dhunës familjare, personat me aftësi të kufizuara, si dhe hapja e inkubatorëve të bizneseve dhe modernizimin e agjencisë së punësimit. Për më tepër, strategjia parasheh edhe inkuadrimin e komunitetit Roma ku çdo vit ofrohen 2.400 bursa për nxënësit e shkollës së mesme të këtij komuniteti, si dhe ofrimi i granteve prej 3.000 euro për projektet e vetë-punësimit për këtë komunitet.

Strategjia e Bashkimit Evropian: “Evropa 2020” - Strategjia evropiane e punësimit synon të krijojë më shumë vende pune dhe bazohet në strategjinë e përgjithshme për zhvillim të njohur si “Evropa 2020”. Ky dokument përmban pesë objektiva kryesore që kanë të bëjnë me punësimin, inovacionin, edukimin, përfshirjen sociale, dhe energjinë që synohen të arrihen deri më 2020³⁹. Sa i përket punësimit, objektivi është që të arrihet shkalla e punësimit në 75% e grupmoshës 20-64 vjeç. Kjo synohet të arrihet përmes tri programeve a) lëvizja e të rinjve, b) programi për shkathtësi dhe

³⁹ European Commission, Europe 2020: Europe’s Growth Strategy, <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?langId=en&catId=956>

punë të reja, dhe c) platforma kundër varfërisë dhe përjashtimit social.

Programi “Të rinjtë në lëvizje” është një gërshetim i politikave mbi edukimin dhe punësimin e të rinjve. Papunësia e të rinjve nën 25 vjeç arrin shkallën e 20% dhe rreth 7.5 milion të rinj (15-24 vjeç) nuk janë as në punë dhe as në shkollim apo trajnim⁴⁰. Andaj qëllimi i këtij programi është ta bëjë shkollimin dhe trajnimin më relevant ndaj nevojave të të rinjve, t’u mundësohet të rinjve të shkollohen apo trajnohen edhe në shtetet tjera përmes ofrimit të granteve të ndryshme. Pjesë e kësaj është edhe projekti “Progress Microfinance” që u ofron të rinjve kredi nën 25.000 euro për themelimin ose zgjerimin e një biznesi. Kredia nuk u jepet direkt ndërmarrësve të rinj, por ua mundëson disa institucioneve mikrofinanciare të përzgjedhura që të rrisin shkallën e huadhënies duke a) lëshuar garancione për ndërmarrësit e rinj, që nënkupton ndarjen e riskut me huadhënësin dhe b) duke ofruar fonde për të rritur dhënien e kredive të vogla.

Programi për shkathtësi dhe punë të reja synon t’i pajisë njerëzit me shkathtësi të duhura për punët e sotshme dhe të nesërme, zbatimin e reformave që kanë të bëjnë me fleksibilitetin dhe sigurinë në tregun e punës (koncepti “flexicurity”), dhe përmirësimin e kualitetit të punës dhe kushteve të punës⁴¹.

Ndërkaq, platforma kundër varfërisë dhe përjashtimit social synon që t’u ndihmojë shteteve të BE-së të largojnë 20 milion njerëz nga varfëria dhe përjashtimi social. BE konsideron se 24% e popullatës së përgjithshme të BE-së janë në rrezik të varfërisë apo përjashtimit social, që përfshinë një përqindje të madhe të fëmijëve, të personave mbi 65 vjeç, dhe grupeve të veçanta siç janë komuniteti roma⁴².

⁴⁰ Për më shumë shih programin e Komisionit Evropian “Youth on the Move”, <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=950&langId=en>

⁴¹ Për më shumë shih programin e Komisionit Evropian “New Skills for New Jobs” <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=958&langId=en>

⁴² Për më shumë shih programin e Komisionit Evropian “European Platform Against Poverty and Social Inclusion”, <http://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=961&langId=en>

VIII. RRUGA PËRPARA

Në një shtet ku shkalla e papunësisë arrin në 30.9%, me një nivel të mos-aktivizimit ekonomik të popullsisë në moshë pune prej 63.1% dhe me një numër prej mbi 250 mijë personave të regjistruar në kërkim të një vendi pune, Qeveria do duhej të kishte një plan shumë serioz dhe konkret për të krijuar vende të reja puna. Strategjia e Punësimit 2010-2012 nuk mund të shërbejë si një model i mirë i krijimit të vendeve të reja të punës në vitet në vazhdim për dy arsye.

E para, kjo strategji është shumë e përgjithësuar. Fokusi kryesor i kësaj strategjie është përshkrimi i problemeve makroekonomike të Kosovës se sa ofrimi i politikave konkrete për punësim. Ajo përmend privatizimin e KEK-ut dhe termocentralit “Kosova e Re”, ndërtimin e zonave industriale, ndërtimin e shkollave të kompetencës, modernizimin e shërbimeve të punësimit dhe obligime të tjera që janë kompetencë e pesë ministrive të ndryshme.

E dyta, kjo strategji nuk është e matshme. Për shkak se strategjisë i mungojnë objektiva të qarta rreth numrit të vendeve të punës që synohen të arrihen gjatë viteve 2010-2012, suksesi i saj vështirë mund të matet. Edhe vetë Qeveria ende nuk ka bërë një vlerësim të hollësishëm rreth efektit të Strategjisë së Punësimit 2010-2012, gjë që do duhej ta bënte.

Andaj, Instituti GAP rekomandon:

1. Kosova duhet ta ketë një strategji të re të punësimit. Përpilimi i kësaj strategjie duhet të udhëhiqet nga MPMS dhe politikat kryesore që propozohen duhet të jenë nën kompetencën e divizionit të punës dhe punësimit të MPMS, kurse partnerët tjerë qeveritarë duhet të jenë më të pakët në numër. Pra, kjo strategji nuk duhet të jetë strategji e përbashkët e pesë ministrive të ndryshme sikurse që ka qenë strategjia e fundit. Kjo për dy arsye. E para, tashmë ministrinë tjera kanë strategjitë e tyre zhvillimore, si për shembull Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, Ministria e Arsimit ka Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016, dhe vetë Qeveria ka Strategjinë për Vizionin Ekonomik të Kosovës 2011-2014. Andaj, nuk ka nevojë për një strategji të re të punësimit ku do të përsëritshin politikat që tashmë përmenden në këto dokumente strategjike.

Dhe e dyta, institucionet qeveritare (ministrinë) nuk kanë treguar ndonjë shembull të suksesshëm të koordinimit për të nxjerrë një strategji të mirëfilltë të përbashkët. Këtë e dëshmon edhe Vizioni Ekonomik i Kosovës i cili megjithëse është përpiluar me angazhimin

e shumë ministrive, nuk mund të thuhet se shërben si një udhëzues ose dokumenti bazë mbi të cilin ndërtohen politikat për zhvillimin e vendit. Andaj, do të ishte më e udhës që barra për përpilimin e strategjisë së re të punësimit të bie mbi MPMS dhe niveli i koordinimit me ministrinë tjera të jetë mes zyrtarëve më të lartë.

2. Strategjia e re e punësimit duhet të përmbajë objektiva të qarta dhe të matshme për rritjen e shkallës së punësimit në vend si dhe të ofrojë mekanizma dhe plane se si do të arrihen objektivat. Mes tjerash strategjia e re duhet të përmbajë këto elemente:

- Strategjia duhet të specifikojë numrin e vendeve të reja të punës që synohen të krijohen ndër vite, numrin e trajnimeve dhe aftësimeve për punë, numrin e bizneseve që do të kalojnë në ekonominë formale dhe numrin e familjeve që do të kalojnë nga asistenca sociale në kategorinë e të punësuarve.
- Qeveria e Kosovës, sikurse në rastin e Shqipërisë dhe Maqedonisë, duhet të vendosë marrëdhënie kontraktuale me punëdhënësit për ta rritur numrin e punëtorëve. Kjo bëhet duke ndarë një grant në kuadër të pakos stimuluese që ka për qëllim rritjen e numrit të punëtorëve tek firmat shumë të vogla, ato të vogla dhe të mesme.
- Pakoja stimuluese duhet të jetë e qartë dhe procedurat për të aplikuar dhe përfituar po ashtu duhet të sqarohen mirë. Fondi për krijimin e pakos stimuluese mund të arrihet edhe përmes një sistemi tejet rigoroz të kursimeve ⁴³. Për shembull, me një grant prej 400.000 euro, Qeveria do të mund të subvenciononte rreth 220 vende pune me pagë prej 150 euro në muaj për një vit të tërë. Nëse do të ofronte vetëm 50% të pagës minimale dhe 50% ta ofronte punëdhënësi, atëherë mbi 500 vende pune do të krijoheshin nga një fond i tillë.
- Sikurse në projektin e BE-së "Progress Microfinance", Qeveria duhet të krijojë një fond ku përmes bankave dhe institucioneve mikrofinanciare ofrohen kredi me interes shumë të vogël për themelimin e ndërmarrjeve të vogla. Pasi se përfituesit do të kthenin kredinë gradualisht duke filluar pas vitit të parë, fondi do të ishte në shfrytëzim për një periudhë të gjatë. Kjo politikë duhet të jetë në koordinim me Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat.
- Strategjia e re duhet të fokusohet më shumë në programet për bujqësi si një mekanizëm për të krijuar më shumë vende

⁴³ Për vitin 2012 Qeveria e Kosovës ka shpenzuar mbi 394 mijë euro vetëm për dreka zyrtare, mbi 214 mijë euro për karburante për vetura dhe mbi 160 mijë euro për telefonin mobile. Për detaje shih platformën e Institutit GAP "Si i shpenzon shteti paratë tona?" <http://www.institutigap.org/spendings/?drekat-zyrtare/2012#/~drekat-zyrtare>

pune. Kjo duhet të bëhet në koordinim me Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Ministrisë së Bujqësisë.



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti për Studime të Avancuara GAP përkrahet nga:



Kjo analizë është përkrahur nga:

